

V E N D I M
Nr. 273, datë 10.6.1999

PËR PËRDORIMIN E NDIHMËS FINANCIARE TË QEVERISË SË PAKISTANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe Minsitrisë së Pushteit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ndihma financiare e qeverisë së Pakistanit prej 5 000 mijë USD, kundërvlehtë prej 700 000 000 (shtatëqind milionë) lekësh, të përdoret nga organet e pushtetit lokal për përmirësimin e infrastrukturës kryesore rrugore të qyteteve, sipas ndarjes së mëposhtëme:

Bashkia e Tiranës	210 milionë lekë
Bashkia e Durrësit	140 milionë lekë
Bashkia e Elbasanit	70 milionë lekë
Bashkia e Vlorës	140 milionë lekë
Bashkia e Korçës	70 milionë lekë
Bashkia e Shkodrës	70 milionë lekë

Këto fonde korrigjohen në përputhje me kursin e këmbimit të valutës së ditës së kryerjes së veprimeve me koeficientin: kurs ditor (lekë/ USD) / 140 lekë/USD.

Bashkëngjitur është lista e objekteve për çdo bashki.

2. Ky fond derdhet nga llogaria e Bankës Kombëtare Tregtare në llogarinë e Degës së thesarit të Tiranës me numër 317/4302. Kundrejt fondeve të arkëtuara Ministria e Pushtetit Lokal autorizon përdorimin e fondeve sipas destinacionit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Shpenzimi i fondeve evidentohet në një strukturë të veçantë buxhetore që përcaktohet nga Ministria e Financave me qëllim evidentimin, raportimin dhe kontrollin e përdorimit të këtyre fondeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Lista e Objekteve sipas Bashkive

	mijë lekë
I TIRANA	210,000
1 Sistem asfaltim Rr. «Ali Demi»	50,000
2. Riparimi digës dhe veprës së shkarkimit në liqenin artificial, Tiranë	140,000
3. Sistem Asfaltim i unazës, segmenti Farmacia 10 - Arkivi i Shtetit	20,000
II DURRËS	140,000
1. Ndërtim i unazës, Durrës	70,000
2. Ndërtim varreza të reja në qytet	56,000
3. Ndërtim i sinjalitikës rrugore në qytet	14,000
III SHKODËR	70,000
1. Ndërtim i Linjës së Tensionit të lartë	14,000
2. Riaftësim argjin. liri Kiri	15,400
3. Ndërtim KUZ rruga Kodra	3,948
4. Ndërtim KUZ zooteknik qendra Dudas	6,020
5. Ndërtim KUZ rruga Zalli	350

	6. Rikonstruksion asfaltim rruga Kongresi i Lushnjes	9,996
	7. Rikonstruksion asfaltim rruga Ndocaj Dudas	9,870
	8. FV Pompe zhytëse stacioni pompimit Dobrac	3,206
	9. FV Pompe shtyese stacioni pompimit Dobrac	3,248
	10. Lidhje energji Elektrike Stac. Pompe Dobrac	2,814
	11. FV saraçineska, karburanti Fermentim	1,148
IV	KORÇË	70,000
	Rikonstruksion Asfaltim rrugor të qytetit	70,000
V	ELBASANI	70,000
	1 Ndërtim kanalizime Ujra të zeza të qytetit	36,700
	2 Sistemim Asfaltim rrugor në qytet	33,300
VI	VLORA	140,000
	1 Rikonstruks. kanali ujrave të larta Spital Nartë dhe ndërtim vepra arti	15,000
	2 Rikonstruksion i kanalit të ujrave të larta	5,000
	3 Përmirësim e sistemim asfaltim në rrugët e qytetit	120,000